



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1541/1 prot.

Tiranë, më 21.06.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike”

**KRYEMINISTRISË**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2263, datë 11.06.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike” së bashku me relacionin shoqërues, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Lidhur me pikën 1 të projektvendimit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike”, vlerësojmë të mbahet në vëmendje që faqja zyrtare e çdo institucioni të jetë në funksion të transparencës proaktive të autoritetit publik, që rregullohet specifikisht nga kuadri ligjor për të drejtën e informimit. Kuadri ligjor specifik lidhur me të drejtën e informimit, parashikon rregulla të detajuara lidhur me vënien në zbatim të programit institucional të transparencës, ku specifikisht pikat 2 dhe 3 të nenit 4, neni 6 dhe neni 7 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe Urdhri i Komisionerit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e programit të transparencës, të rishikuar”, i ndryshuar përcaktojnë kategoritë e informacionit, që bëhet publik pa kërkesë, si dhe mënyrën e bërjes publike të këtij informacioni.

Për rrjedhojë formati i informacionit, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të çdo autoriteti publik, sipas përcaktimeve të projektvendimit, nuk duhet të krijojë mbivendosje apo konfuzion me detyrimet ligjore për transparencë dhe formatet, që rrjedhin nga kuadri ligjor specifik në fuqi për të drejtën e informimit.

Lidhur me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, nga përmbajtja në tërësi e projektvendimit, vërejmë disa rregulla në të cilat është parashikuar respektimi i mbrojtjes së të dhënave personale (konkretisht pika 4 dhe 9 e tij), megjithatë duke qenë se përdorimi i të dhënave personale me mjete elektronike kërkon garanci shtesë për mbrojtjen e tyre, sugjerojmë si më poshtë vijon:

Pas pikës 8, të projektvendimit të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

*“Përpunimi i të dhënave personale në çdo rast do të kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Me reflektimin e propozimit të mësipërm, ky projektvendim do të konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**